



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 12**

**Prishtinë, më 27.3.2018, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Xhelal Sveçla, Danush Ademi zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Igor Simiq, kryetar i komisionit, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Slobodan Petrović, anëtarë.

**Nga pjesëmarrësit tjerë:** Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: koordinatorë - Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu-zyrtare e lartë e fushës.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i parë i komisionit.

**Rendi i Ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtura me dt. 7.03.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Xhelal Sveçla*, zëvendëskryetar i parë, me theks të veçant tha se anëtarët e Grupit Parlamentar të Listës Serbe nuk do të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit, dhe në mungesë të kryetarit, takimet e komisionit unë do ti udhëheqi.

Në fillim, i njoftoi anëtarët e komisionit, se në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 23 mars 2018, me qëllim që të shqyrtit dhe miratimit të projektligjeve të parapara nga Agjenda për Reformë Evropiane (ARE) dhe Raportit me vendim, të cilat do të miratohen deri më 31 mars 2018, si dhe me propozimime e Kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, Kryesuesi nxorri këtë:

## Vendim

Shqyrtimi dhe miratimi i prprojektligjeve të parapara me Agjendësn për Reformë Evropiane (ARE) të bëhen me procedurë të përshpejtuar, nga shmangia e afateve procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7, neni 57, paragrafët 3,8 dhe 9 dhe nenin 64, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit. Për arsye të respektimit procedural, për shqyrtim janë dhënë edhe dy projektligje; Projektligji nr.06/L-026 për Azil dhe Projektligji nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt. Ai kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen për plotësimin e rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjeve të propozuara.

*Zëvendëskryetari*, konstatoi se anëtarët e komisionit u pajtuan që rendi i ditës të plotësohet me dy pika ; shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-026 për Azil dhe Projektligjit nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtura me dt. 7.03.2018.**

*Zëvendëskryetari*, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së Komisionit të mbajtur me dt 7.03.2018, miratohet njëzëri, pa vërejtje.

*Zëvendëskryetari*, para se të fillohet me shqyrtimin e Raporteve me amadnamete të komisioneve funksionale, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të vendosin për mënyrën e votimit të amadamenteve një nga një apo votimi të bëhet në pako, dhe të njejtit u deklaruan për verzionin e dytë.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**

*Zëvendëskryetari*, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funksional, komisioni nxori këtë:*

## Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-026 për Azil, me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së ;**

*Zëvendëskryetari*, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-026 për Azil dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, komisioni nxori këtë:*

### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-026 për Azil dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt, me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së ;**

*Zëvendëskryetari*, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim konkret në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

*Komisioni shqyrtoi Projektligjin dhe Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe nxori këtë:*

### **Rekomandim**

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të Huajt dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:40.*

*Pregadiur nga stafi mbështetës i Komisionit*

**Zëvendëskryetar i Komisionit,**

---

**Xhelal Sveçla**